REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 596/22
Datë/Datum. 18.11.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Agim Sheqiri-Ekspert Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. lëndës:
	04.11.2022	18.112022	596/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 28. 10 2022 OE. "Pharma Leader" LLC ka parashtruar ankesë me numër: 596/22 për aktivitetin prokurimit me titull "Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me nr. te prokurimit: 206- 20-8397-1-1-1të realizuar nga Ministria e Shëndetësisë

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, kontratë për furnizim dhe vlera e parashikuar për Lot 1 1,239,245.44 Euro , ndërsa për Lot 3 vlera e parashikuar ka qenë 4,851,824.16 Euro

- Njoftimi për kontratë është publikuar me date 12.12.2020 , ndërsa hapja publike është bere me date 05.01.2021
- Publikimi i vendimit për rekomandim është bërë me datë 22.02.2021, dhe për kontratë për llot I dhe III rekomandohet OE "Pharma Leader" LLC me çmim prej 1,097,467.36 Euro per Lot I dhe 4,109,006.12 Euro për Lot III
- OE"Pharam Leader"LLC me date 10.03.2021 parashtron kërkesë për rishqyrtimit e cila nga ana e Autoritetit Kontraktues konsiderohet si e pa bazuar dhe si rezultat i refuzimi te kërkesës për rishqyrtim me datë 15.03.2021 parashtron ankesë në OSHP, dhe sipas vendimit te Panelit Shqyrtues nr. 240/21 të datës 25.03.2021 kërkohet rivlerësim i aktiviteti të prokurimit.
- Edhe pse Paneli Shqyrtues lëshon vendim për rivlerësim AK përsëri me datë 28.04.2021 nxjerr vendim ku përsëri për kontratë rekomandon OE "Meditech"
- Me date 30.04.2021 OE. "Pharam Leader"LLC parashtron kërkesë për rishqyrtim e cila refuzohet nga nga AK dhe si rezultat i kësaj parashtron përsëri ankesë ne OSHP për te cilën ankesë është lëshuar një ekspertizë nga eksperti shqyrtues i cili gjithashtu rekomandon qe aktiviteti i prokurimit te rivlerësohet pasi qe vlerëson se pretendimet ankimore janë të bazuara .
- Pas vendimit të OSHP-së- nr . 397/21 Autoriteti kontraktues me datë 12.08.2022 publikon njoftimin mbi vendimi e AK për anulim të aktivitet të prokurimit.
- OE "Pharma Leader" kundër këtij vendimi me datë 16.07.2022 parashtron kërkesë për rishqyrtim
- Kërkesa e parashtruar për rishqyrtim nga ana e AK-së konsiderohen si kërkes e pa pabazuar dhe sipas njoftimit mbetet në fuqi vendimi për anulim te aktivitet të prokurimit.
- Operatoret Ekonomik i lartcekur me date 26 dhe gusht parashtrn ankesa ne OSHP me nr protokolli 397/22
- Me datë 15.09.2022 është lëshuar ekspertiza nr 397;409/22 dhe nga e eksperti shqyrtues ndërsa ekspertiza palëve ju është konfirmuar me datë 23.09.2022
- Me datë 11.10.2022 Peneli shqyrtues leshon vendim me anë të cilit kërkohet që aktiviteti te rivlerësohet
- Ndërsa me datë 20.10.2022 AK e publikon njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

Neni 1 i LPP-së Neni 6 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 52 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 60 i LPP-së Neni 62 i LPP-së Neni 69 i LPP-
Neni 70 i LPP-së
Neni 105 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 130 i LPP-së
Neni 131 i LPP-së
Neni24,.31 dhe 40 i RROUPP-së
Vendimi PSH.te OSHP-se Nr.397,409/22 të dt.11.10.2022
Ekspertiza e ekspertit shqyrtues te OSHP-se Nr.397,409/22 e dt. 15.09.2022 Dëshmia e vazhdimit te validitetit te ofertës.

Te nderuar, konform nenit 109, te LPP-se parashtron ankesën e radhës dhe prezantojmë fakte te abuzimit dhe mos zbatimit te ligjit per prokurim publik dhe mos zbatim te vendimit te Organit Shqyrtues te Prokurimit, ne 397-409/22 te datës 11.10.2022.

Pretendimi ankimore nr.l - Validiteti I ofertes.

Kompania PHARMA LEADER LLC, me datën 20.10.2022, ka pranuar njoftimin e rezultatit te aktivitetit te prokurimit me titull: "furnizim me insulina analoge nga lista esenciale" per lotin 1 dhe 3 me nr. prokurimi: 206-20-8397-1-1-1. AK - Ministria e Shendetesise, me doemos kërkon anulimin e aktivitetit te prokurimit, përkundër faktit se lotin 2, pikërisht te kësaj procedure tani është konsumuar dhe per kunder faktit se keto Lote 1 dhe 3 tani jane stergjykuar me vlerësim te ofertave me ekspertiza dhe me vendime te zyrtareve përgjegjës dhe te organeve pergjegjese sic eshte edhe vendimi i fundit i Organit Shqyrtues te Prokurimit.

Me këto veprime te Zyrtarit Kryesor Administrative dhe Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit, te MSH- se, shihet qarte se ju ka humbur arsyeja, meqe e kane kuptuar qe nuk do te amnistohen nga pergjegjesia penale, si rezultat i abuzimit me parane publike dhe shkeljeve ligjore.
Tentimi për anulim te aktivitetit te prokurimit, ne formën e tille detyrimisht, zyrtaret e Autoritetit Kontraktues, edhe me teje i inkriminon dhe ngarkon me pergjegjesi penale.
Po te shikohet vendimi i date 20.10.2022, ku kërkesa jone refuzohet le per te kuptuar se ZKA dhe ZKP, kerkojn meshire per amnistim nga përgjegjësia penale tani e konsumuar, si rezultat i abuzuimit dhe demtimit te rende qe i kane shkaktuar paras publike dhe ate permes kategoris me te ndieshme te shoqeris tone te diagnostifikuar me semundje kronike - diabetike. Pra perkunder gjykimit me vendim te OSHP-se, asesi nuk trajtojn pretendimet tona ankimore ne raport me kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate te vet percaktuara dhe te vet publikuara nga AK - MSH. Ne te njejtin vendim AK - MSH, thirren ne opinione te KRPP-se ku perseri shtremberohet realiteti, manipulohet realiteti, tentohet te mashtrohet dhe lajthisin cdo instanc ligj zbatuese.
Kompania PHARMA LEADER LLC, disponon dhe ju prezanton si prove te gjitha shkresat dhe te gjitha provat qe oferta jone ne cdo hap te procedures se kerij aktiviteti te prokurimit ka patur validitet ku edhe vet zyrtaret e prokurimit e konfirmojnë ne gje te tille. Përkundër këtij fakti vet kompania jone është ajo qe i ka

kujtuar dhe ri kujtuar AK-se qe duhet te kerkohet validiteti i ofertës sepse është obligim ligjor i AK-se jo edhe i opeatorit Ekonomik.

Tentohet te anulohet procesi per validitet te vitit 2021!

Kthimi ne retrospektive dhe atë per validitet te vitit 2021, per te tentuar amnistine duke shkelur cdo ligj dhe cdo rregull te mundeshem per prokurim publik, perfshire ligjin per menaxhim te financave publike, kodin penal, ligjin per procedur te pergjitheshme administrative, e shum ligje tjera eshte i pa mundur dhe duhet te kuptoket nga zyrtaret tani me pergjegjes ,se kthimin ne kohe eshte i mbinatyrshem dhe i pa mundur. Pra kompania jone i kemi bere me dije AK- se se, neni 31.4 i Rregullave te RRUOPP-se percakton: " *AK do te kerkoj nga OE te zgjasin validitetin e tendereve te tyre. Kerkesa perzgjatjen e validiteti te tenderit do te behetme shkrim dhe duhet tekerkohet para dates se skadimit".* Edhe kete obligim AK - MSH, nuk e ka zbatuar perkundrazi ne si kompani PHARMA LEADER LLC, ju kemi perkujtuar obligimet e tyre ligjore. (Prove 1: Deshmia e vazhdimit te validitetit.

Pikerisht per kete qeshtje ekziston vendim i Bordit paraprak ende ne fuqi qe validiteti i ofertave eshte vetem pergjegjesi e AK-se dhe asesi e OE--se, madje me rregullore te KRPP-se është ndëshkuese mos kerkesa per vazhdim te validitetit te ofertave.

Pra validiteti dhe udhezimi administrative janë pjese e dosjes, pjese e ofertes dhe pjese e kritereve kualifikues dhe si te tilla duhet te mbeten.

Te nderuar anetare te Bordit te OSHP-se, AK - MSH tani e ka kuptuar se abuzimet ligjore dhe vazhdimi i monopolit tani e tutje nuk do te ndodhe. Pasi qe eshte parimi baze i prokurimit publik dhe konkurreces se lire te tregut.

Poashtu anetaret e secilit komision vleresues te caktuar nga AK - MSH ekspert te fushes specifike asnjehere nuk e kane kontestuar dhe vene ne dyshim cilesine dhe sigurine e produktit dhe jane te bindur qe produktet tona i plotesojne te gjitha kerkesat e percaktuara te Specifikimi Teknik ne Dosje te Tenderit sepse produktet tona jane prodhim Amerikan dhe te regjistruara ne Agjencionet me prestigjoze per Regjistrim te Produkteve Medicinale sic eshte EMA dhe FDA, por leshohen ne vleresimin e qeshtjeve administrative dhe Ligjeve te LPP-se per te cilet nuk jane te kualifikuar te bejne vleresimin, por kete e bejne me ndikim nga ana e zyrtareve pergjegjes te AK-MSH.

Pretendimi ankimore nr. 2 - Shfuqizimi I Udhezimit administrative 02/2014 ne mes nate dhe fuqizimi IUA 01/2022.

Shfuqizimi IAU 02/2014, ne mesnate dhe nxjerrja e UA te ri edhe me teje e zgjeron abuzimin, veq se tani inkriminon edhe persona tjere.

Ligji per procedure e pergjithshme administrative, neni 53 - Kapitulli III, percakton anulimin dhe shfuqizimin e akteve administrative. Paragrafi 2, eshte i qarte dhe potencon qe, shfuqizimi i aktit administrative ka pasoja vetem per te ardhmen jo edhe per te kaluaren.

Per me teper, neni 58,1 LPPA-se percakton afatet kohore te anulimit dhe shfuqizimit te nje akti administrative te ligjeshem, pra paragrafi 2, percakton qe: *Anulimi apo shfiqizhni, ne cdo rast tjeter mund te behet brenda 30 diteve nga data kur organipublik ipercaktuar sipasparagrafit 1 te nenit 53 te ketije ligji,njoftohet me faktet qe justifikojne amdimin apo shfuqizimin, por jo me vone sepese 5 vjet nga njofiimi i aktit administrative.*
Udhezimi administrative. 02/2014, eshte publikuar me daten 22.08.2014. Eshte shfuqizuar me daten 21.10.2022. Pra i njejti UA, ka kaluar periudhen kohore ligjore per tu shfiiqizuar, I njejti mund te amandamentohet - plotesohet por asesi te ndryshohet apo shfuqizohet si ka vepruar AK – MSH.

Shfuqizimi UA 02/2014, inkriminon edhe me tutje me pergjegjesi penale zyrtaret pergjegjes te cilet "punojne edhe ne mes nate per te perfituar kunderligjeshem ne dobi per vete apo per tjetrin dhe per te krijuar monopol

Pretendimi ankimore nr. 3 - Krijimi i komisionit ri vleresues te ofertave - Endokrinolog per validitet oferte!

Abuzimi me dispozita ligjore dhe financa publike, tani me ka tejkaluar edhe logjiken. Per te vleresuar validitet te ofertave AK - MSH, pas vendimit te OSHP-se me nr. 397-409/22 nuk kane pasur guxim qe ne komision vleresues te caktoje se paku nje anetare Zyrtare te Prokurimit te cilet jane pergjegjes per vleresimin e Kerkesave mbi mundesite teknike/profesionale pika 9.1&9.2 ne Dosje te Tenderit por autorizon dhe inkriminon profesionist te fushes specifike "endokrinolog", te cilet pa dyshim qe ne asnje forme apo rrethane nuk mund ta kontestoje cilesin, kualitetitn dhe efektivitetitn e produkteve tona, por quditerisht "vleresojne ", pjesen administrative dhe proceduren e prokurimit dhe ate ne retrospektive, ku haptas ndikohen dhe lajthiten nga zyrtaret pergjegjes te prokurimit me qellimin qe pergjegjesia penale te shpemdahet sa me shume edhe tek persona tjere. Kompania jone Pharma Leader LLC, me pergjegjesi te plote deklaron se me demet financiare te shkaktuara dhe tani te konstatuara nga AK-MSH qe perbejne shkelje te rende te LPP-se dhe jane pergjegjes per moszbatimin e Ligjeve te LPP-se ka prova konkrete per procedure penale per ZKA dhe ZKP.
AK - MSH, mkrimininon ekspert shendetesor per te vleresuar validitetit te ofertave ku kjo gje eshte e ndaluar dhe shkelje flagrante e dispozitave ligjore.
Neni 40, "Krijimi I komisionit vleresues te tendereve, te Rregullave te RRUOPP-se percakton qe: pergjegjesi-ekrijimit te komisionit eshte e Zyrtarit Kryesor Administrativ, ne bashkpunim te ngushte me Zyrtarin kryesor te Prokurimit. Paragrafi 6, i po ketije neni percakton qe, *"AK qarte do te percaktoj detyrat e komisionit, te cilat ne asnje menyre nuk do te kufizojnepavarsine e komisionit neprocesin e vendim marrjes.* Pra ZKA dhe ZKP, tani me kane shkelur edhe kete dispozit ligjore dhe kane konsumuar veper te re penale "ushtrimi i ndikimit te kuiiderligjeshem" e sanksionuar me Kod Penal te Kosoves.
Paragrafit 10, i nenit 40 te RRUOPPs, rrepetsisht e ndaluar inkriminimin e eksperteve te fushes specifike dhe mos te konstatojne kualitetin dhe cilesin e produkteve tona por validitetin e ofertes se fillim vitit 2021, perkunder ketije fakti nuk vleresohet qellimi dhe objekti I procedures se prokurimit nga "ekspertet e fushesh, te propozuar nga SHSKUK dhe te miratuar nga ZKA i AK-se" edhe pse per kete qeshtje AK - MSH, ka mbi 150 punonjes - zyrtare te cilet jemi te bindur se pergjegjesin do ta bartnin te AK per mos kerkim te vazhdimit te validitetit dhe jo tek kompania jone e cila ka ofruar validitetin pa e kerkuar AK fare.
Sipas raportit te komisionit vleresues te ofertave "eksperteve" eshte skandaloz, fakti ku potencoheet se kompania jone nuk e ploteson piken 2 - Autorizimin per Marketing. Per kete vleresim nje gje eshte e sigurt ose eshte ushtruar ndikim i kunderligjeshem ndaj komisionit te vleresimit nga zyrtaret e AK-se, ose nuk i eshte prezantuar dosja e tenderit - kerkesat e kualifikimit fare. Pra ri vleresimi eshte I turpshem ku tani, kemi 2 vendimi te OSHP-se dhe 5 raporte te ekspertizave nga Ekspert te OSHP-se qe e trajtojne pikerisht kete qeshtje. Pra me kete veprim perveq qe shkelen dispozitat e nenit 59, te LPP-se, shkelen edhe shenjat e

pikesimit ku kerkesen e Dosjes se Tenderit e interpretojne ne menyre tendencioze duke e marrur vetem nje pjese te kerkeses e cila eshte ne kundershtim me kerkesen dhe deshmine e parashtruar ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosjen e Tenderit qeshtje kjo e cila eshte gjykuar dhe vertetuar si shkelje disa here nga ana e Eksperteve dhe Panelit te OSHP-se. ku patjeter kompania edhe keto veprime kunderligjore do ti raportoi ne Prokurin e Shtetit te Republikes se Kosove.

Pra per -vemendjen e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues pse jo edhe te Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Zryrtarit Kryesore te Prokurimit - abuzuesit e ligjeve dha shkaktaret e demeve te medha financiare te buxhetit te shtetit, neni 70, I LPP-se, STANDARDET PER SIGURIMIN E CILESISE, percakton *"Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. AutOliteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikuespavarësishtnga vendi, nëse organii tillëpranohetnga njështet anëtariBE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje osemundësipër sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara*

Dispozita e larte shenuar qarteson faktin se udhezuesi administrative ne kohen e inicimit te procedures se prokurimit ka qene valid dhe i ligjeshem dhe do te jet edhe ne te ardhmen sepse kjo eshte e rregulluar me Kushtetuten e Republikes se Kosoves. Pra produkti jone eshte produkt i pranuar dhe certifikuar jo nga nje shtet i BE-se por nga te gjitha shtetet anetare te BE-se. Pra kete dispozit ligjore AK - MSH nuk do te mund ta shfuqizoje.

Pretendimi ankimor nr. 4 - Mos zbathni i vendimit te Panelit Shqyrtues te OSHP-se nr 397,409/22 Bazuar ne vendimin e fundit PSH nr.379-409, ankesa e kompanise tone PHARMA LEADER LLC, eshte aprovuar ne teresi e bazuar, perderisa ankesa tjeter, e OE te favorizuar nga zyrtare te AK-MSH, eshte refuzuar e pa lëjuar dhe e pa afatshme. Per kunder ketije fakti AK-MSH, permes ri vleresimit te ofertave dhep.ermes komisonit te specializuar (per vleresim te validitetit te ofertes dhe jo cilesise) nuk e perjashton por i degron Leter Standarde me qellimin e vetem qe ta beje pjese te procedures edhe pse PSH me te njejtin vendim e ka vleresuar si e palejuar per shqyrtim. Quditerisht vleresuesit e validitetit potencojne se oferta e tyre eshte e vetmja dhe i ploteson te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit!.

Vendimi i njëjte ka obliguçr AK- MSH qe te kthej ne ri vleresim lotin 1 dhe 3, duke e kualifikuar oferten tone

sit e pergjegjeshme ne raport me kerkesat e AK-se, duke trajtuar ne menyre te qarte se:
AK-MSH, ka demtuar buxhetin ne vlere prej 400, 000.00 euro.
Eshte konstatuar se anulimi i aktivitetit te prokurimit eshte bere ne menyre kunder ligjore, ne kundershtim me nenin 62, te LPP-se.
Nuk eshte perfillur vleresimi i pare ku kompani jone eshte rekomanduar per dhenie te kontrates, Nuk eshte perfillur vendimi me nr. 240/21 i PSH-se te OSHP-se I dates 25.03.2021 Anashkalimi i kritereve te kualifikimit.
Mos zbatimi i vendimit 397-409/22 PSH te OSHP-se dates 11.10.2022 e shume shkelje tjera.
Pretendimi ankimore nr. 5 - Kontratat e inicuara dhe te lidhura me UNOPS
Per procedura e prokurimit per te cialt neve si kompani jemi perjashtuar, nuk jemi ftuar dhe nga e drejta kushtetuese e paraqitjes se ankeses jemi privuar ju njoftojme se kompania jone ka hartuar analiz financiare te cilen tani e ka deponuar ne Prokurim e Shtetit ku demtimi i buxetit te shtetit eshte shkaktuar vetem per bartje te procesit tek UNOPS eshte ne vlere prej mbi 600.000,00 Euro.
Keto veprime, bien ndesh me nenin 24, te Rregullave te RRUOPP-se, paragrafi I, ku percaktohet qe " Te gjitha aktivitetite e proknrimit jane pergjegjesi e AK-se, pavaresisht nga shpemdarja e detyrave brenda AK-se sipas nenit 22, te ketij ligji. Kjo nuk zbatohet kur Ministri i financave e ka caktuar AQP-ne per kryerjen e nje aktivitetit te prokurimit sipas ketij ligji... Pra kompania jone e ka njoftuar AK- MSH me keto veprime kunderligjore ne ju kemi ri kujtuar ne vazhdimesi kontratat e lidhura me UNOPS, per te cilat perseri kan abuzuar me parane publike me qellimin e vetem perjashtimin e kompanise tone favorizimin e kompanise tjeter dhe zgjatjen e jetes se MONOPOLIT. Pra kjo dispozit juve rreptesisht ju ndalon inicimin e procedurave te prokurimit nga etnitet tjeter dhe patjeter qe edhe per keto shkejle do te te pergjigjen para organeve te drejtesise.
Duke vazhduar praktiken e vendimeve kontradiktore dhe ne kundershtim me LPP, AK edhe pas Raportit te Ekpsertizes me nr. 397,409/22 te dates 15.09.2022 dhe vendimin e Panelit Shqyrtues te OSHP-se me nr 397,409/22 te dates 11.10.2022 I cili I tregon qarte AK-se se oferta jone eshte e pergjegjeshme dhe duhet te jete e barazvlefshme, bazuar ne nenin 105 te LPP-se perkatesisht paragrafi 2.16 ku aktivitet I prokurimit duhet te trajtohet si qeshtje e gjykuar - res judikata, sepse palet jane te njejta dhe pretendimet e njejta ankimore si dhe objekti i kontestit eshte i njejte dhe ne te shpallemi fitues, por AK-MSH edhe pas vendimit te OSHP-se per arsye te njejta perseri na ka eliminuar edhe pse OSHP me vendimin e cekur me larte e ka aprovuar ankesen dhe pretendimet tona, mirpo edhe kete vendim te OSHP-se AK-MSH nuk e ka marr fare parasysh edhe pse e obligon Ligji I Prokurimit Publik, dhe ne baze te ketij Ligji cilesohet si shkelje e rende e Zyrtareve pergjegjes te Prokurimit.
Duke vazhduar praktiken e vendimeve kontradiktore dhe ne kundershtim me LPP, AK edhe pas Raportit te Ekpsertizes me nr. 397,409/22 te dates 15.09.2022 dhe vendimin e Panelit Shqyrtues te OSHP-se me nr 397,409/22 te dates 11.10.2022 I cili I tregon qarte AK-se se oferta jone eshte e pergjegjeshme dhe duhet te jete e barazvlefshme, bazuar ne nenin 105 te LPP-se perkatesisht paragrafi 2.16 ku aktivitet I prokurimit duhet te trajtohet si qeshtje e gjykuar - res judikata, sepse palet jane te njejta dhe pretendimet e njejta ankimore si dhe objekti i kontestit eshte i njejte dhe ne te shpallemi fitues, por AK-MSH edhe pas vendimit te OSHP-se per arsye te njejta perseri na ka eliminuar edhe pse OSHP me vendimin e cekur me larte e ka aprovuar ankesen dhe pretendimet tona, mirpo edhe kete vendim te OSHP-se AK-MSH nuk e ka marr fare parasysh edhe pse e obligon Ligji I Prokurimit Publik, dhe ne baze te ketij Ligji cilesohet si shkelje e rende e Zyrtareve pergjegjes te Prokurimit.

Knmpania PHARMA LEADER LLC, kerkon qe Paneli Shqyrtues Ankesen tone ta aprovoj ne teresi si tebazuar dhe.
Sipas nenit 130, te LPP-se ta raportoi Ndikimin e pa ligjeshem te ZKA DHE ZKP- te MSH-se, ku qarte eshte e dukshme dhe shperfaqur ndikimi i kunderligjeshem, pasi qe ne vleresimin e 5 te ofertave angazhohen ekspert te fushes - endokrinolog per te vleresuar validitetitn e ofertave dhe jo cilesine dhe efektivitetin e produkteve.
Sipas paragrafit 3, te nenit 130, te raportohen zyrtaret e AK-se per veprimet e kunderligjeshme te vazhdueshme dhe te kontatuara tek Ministria e Puneve te Brendeshme.

Te Urdherohet AK- MSH , qe te zbatoj vendimet paraprake ku eshte gjykuar dhe vertetuar se oferta e kompanis tone I ploteson te gjitha kerkesat e kualifikimit.
ANULOHET, vendimi i AK-MSH i dates 20.10.2022, per anulim te loteve 1 dhe 3
URDHEROHET - AK- MSH, qe te zbatoj vendimin e OSHP-se,me nr. Nr.397,409/22 të dt .11.10.2022, poashtu te kerkohet nga KRPP, qe te revokohet certifikata e prokurimit ndaj zyrtarit te prokurimit z. Berat Marmullaku.
Ne si kopmani do ti vazhdojmë procedurat tona edhe ne organet tjera ligje zbatuese dhe ti raportojme demet e shkaktuara financiare si rezultat i lidhjeve te kontratave te negociuara nga AK dhe mos fteses ndaj kompanis tone ne procedura te negociuara, perkunder obligimeve ligjore dhe te kontestuara

Tabela.1 Çmimet e ofruara sipas procesverbalit të hapjes publike të datës 05.01.2021

Nr.	Tenderuesi	Pjesë Lot I Lot III	e-tenderit	Çmimi (me TVSh)	Ndryshimi/
1.	PHARMA LEADER L.L.C.. Veternik, rr. e Gjilanit p.n.,, 10000, Prishtine	loti-1	PO	1,097,4670.36	JO
2.	PHARMA LEADER L.L.C.. Veternik, rr. e Gjilanit p.n.,, 10000, Prishtine	loti-3	PO	4,109,006.12	JO
3.	MEDITECH, e Livadhit Çagllavicë. 10000, PRISHTINË	loti-1	PO	1,144,726.72	JO
4.	MEDITECH, e Livadhit Çagllavicë. 10000, PRISHTINË	loti-3	PO	44,569,08.24	JO

KRITERET PËR KUALIFIKIM DHE VLERËSIM

AK në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë ka parashtruar kriteret e përzgjedhjes si në vijim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.	1. Deklarata nën Betim.
2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të	2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.
3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.	3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.	1. Certifikata e biznesit - kopje.
2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.	2. Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal - kopje.
3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik - kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove.	3. Kopje e Certifikatës se TVSH-se - kopje.
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
1. Te dështmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi apo nga distributori i	1. Autorizim nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar, per tenderin përkatës
autorizuar, për tenderin përkatës, (nëse autorizimi është nga distributori atëherë si dështmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit) për shitjen e produkteve qe ofertoni. Autorizimi te përmbajë te dhëna te mjaftueshme te kontaktit për prodhuesin, me qëllim te	(me te dhëna mbi prodhuesin, si psh adresa, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi te verifikimit).

2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02/2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e	2. Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02/2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certificatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).
3. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike.	3. Licenca nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet) Kërkohet kopie.

Kriter për vlerësim ka qenë çmimi më i ulët i poentuar sipas tabelës në vijim:

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimim 240/21; vendimi 397,409/2022

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE-ve ANKUES

Përgjigjeje në pretendimet ankimore

Sqarim informues

Me datë 11.10.2022 Peneli shqyrtues i OSHP ka leshura vendim nr. 397,409/22 dhe ka kërkuar nga AK-Ministria e Shëndetësisë që aktivitetin prokurimit ta rivlerësoj.

<u>Pretendimi Ankimor nr. 1 validiteit i ofertës.</u>

Lidhur me ketë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues jap këtë konstatim dhe vlerësim:

Pas pranimi te vendimit të panelit shqyrtues autoriteti kontraktues ka rivlerësuar ofertat dhe sipas rezultateve te rivlerësimit OE " PHRAM LEADER"LLC refuzohet për këto arsye:

Oferta ka ndërprerje te vlefshmërisë. Oferta ka pasur vlefshmërinë fillestare deri me datën 05.05.2021,

ndërsa kërkesa për zgjatjen e validitetit te tenderit është bere me datën 18.06.2021, vazhdimi i vlefshmërisë nga ana juaj është bere rreth 45 dite pas skadimit te vlefshmërisë se ofertës.
Bazuar ne Opinionin Ligjor te KRPP-se tek pyetjet e shpeshta Nr. 69. e datës 06.02.2020. specifikohet se:
Neni 31.3 i RRUOPP kërkon rreptësisht që oferta të etë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.
Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.
Nuk e keni plotësuar kriterin Nr. 2 - Autorizimin për Marketing nga AKPPM, ndërkohë qe për te njëjtat Lote kemi oferte me AM.
Komisioni i rivlerësimit konsideron se për Insulina Analoge kërkesa e MSH-se duhet te jete vetëm me Autorizim për Marketing, konform dispozitave qe parashihen me Ligjin Nr.04/L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale

Validiteit i ofertës sipas nenit 31 të UOPP trajtohet si ne vijim:

31.1. Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe të specifikuar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve
31.3 periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës.
31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)
31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.
31.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

Ne kontest te këtij arsyetimi përgjegjësia është e autoritetit kontraktues e jo e operatorëve ekonomik dhe ne asnjë rrethanë nuk mund te justifikohet anulimi si rezultat i pa përgjegjshmërisë të zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues.

Për me tepër autoriteti thotë oferta e OE ka pas vlefshmëri deri me datë 05.05.2021 ndera ne kemi kërkuar zgjatje te validitit me datë 18.06.2021 dhe kjo tregon për parregullsitë apo vet neglizhencën e autoritetit kontraktues, sepse diapozitivi i UOPP tek neni 31.1 shumë qartë thotë : *Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)*

Pastaj si është e mundur qe si justifikim për anulim te merret për baze validitetoi kur deri nga datën e theksuar autoritetit kontraktues ka marrë vendime lidhur me ketë aktivitet te prokurimit dhe ka trajtuar kërkesa për rishqyrtim dhe ne asnjë rast nuk është përdor ky arsyetim.

Bazuar ne praktika e tilla te autoriteteve kontraktues Organi shqyrtues i Prokurimit lidhur me ketë cështje me datë 25.11.2014 lidhur me validitein e ofertave.

Provë: vendimi i OSHP-së me nr . 884/14 i datës 25.11.2014

Pavarësisht asaj qe u tha me larte Eksperti konsideron se në asnjë rrethanë AK nuk mund te justifikoj papërgjegjësitë e tyre në dem të OE pasi qe OE konsiderohet se hjek dorë nga aktiviteti i prokurimit në momentin kur e pranon njoftimin për zgjatje te validitetit dhe nuk e konfirmon zgjatjen e vlefshmërisë.

Për ketë aktivitet të e prokurimit autoriteti kontraktues ka shqyrtuar kërkesa për rishqyrtim ka marrë vendime për pezullim dhe ka marre vendime për refuzim te kërkesave për rishqyrtim dhe arsyet e eliminimit në vendimet paraprake kanë qenë krejtësisht tjera.

Për me tepër i referoheni ekspertizës nr 397dhe 409/2022

Gjithashtu arsyetimi për anulim te aktiviteti të prokurimit se Komisioni i rivlerësimit konsideron se për Insulina Analoge kërkesa e MSH-se duhet te jete vetëm me Autorizim për Marketing, konform dispozitave qe parashihen me Ligjin Nr.04/L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale është justifikim i pa qëndrueshëm për arsye se Autoritetit kontraktues ne dosje te tenderit tek kërkesat kualifikuese sipas nenit 69 të LPP specifikishtë përveç kërkesave kualifikuese tjera AK ka parapa kërkesat si në vijim:

- Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02/2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e d si dëshmi lidhur me këto kërkesa ka paraparë si ne vijim:

Dëshmitë te cilat duhet ti ofrojnë OE që oferte e tyre të konsiderohet e përgjegjshme janë:

- Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02/2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certificatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).

Sipas nenit 59 te LPP-së komisioni vlerësues ne asnjë rrethanë nuk mund të anashkaloj kriteret që janë përcaktuar në dosje te tenderit dhe çdo devijim nga kriteret e përcaktuar nënkupton devijim dhe me ketë rast krijon favore respektivisht disfavore në dëm apo në dobi të njërës apo tjetrës palë, dhe kjo bie ne kundërshtim me parimet bazike të LPP-së konkretisht nenin 7 Barazia ne trajtim /diskriminim.

Komisioni i vlerësimit është i thirrur gjatë vlerësimit ti respektoj kriteret që janë përcaktua ne dosje te tenderit.

Pretendimi ankimor nr 2 .Shfuqizimi I Udhëzimit administrative 02/2014 ne mes nate dhe fuqizimi IUA 01/2022

Lidhur me ketë qeshje eksperti nuk mund t jap vlerësimi pasi qe përgjegjësit dhe kompetencat e Ekspertit Shqyrtues janë për të vlerësuar dhe gjykuar pretendimte ankimore qe lidhen me aktivitetin e prokurimit duke filluar nga dosja e tenderit nëse kemi të e bëjmë me ankese ne fazën e tenderimit apo kriteret e përzgjedhjes nëse kemi te bëjmë pas fazës se tenderimit konkretisht me vlersimin apo rivlerësimin e tenderit.
Pra eksperti nuk është i thirrur të vlerësoj apo gjykoj çfarë ndikimi mund të ketë shfuqizimi apo fuqizimi i një norme administrative qofte rregullore, udhëzim apo vendim që nxirret nga organe tjera por është i thirrur për të vlerësuar mbi bazën e kritereve kualifikues dhe vlerësues dhe mbi bazën parimeve te LPP-së .

Pretendimi ankimore nr. 3 - Krijimi i komisionit ri vlerësues te ofertave - Endokrinolog për validitet oferte

Neni 59 i LPP-së ne mënyrë te qarte e sqaron se si vlerësohet një aktivitet i prokurimit si formohet komisioni dhe cilat janë përgjegjësit e tij..

Sipas rregullave të prokurimit AK-së i lejohet ne raste të caktuar qe të caktoj edhe ekspert te jashtëm për çështje specifike madje ne mungese ekspertëve të brendshëm.

Çështjet administrative siç është validiteti apo kërkesat kualifikuese lidhur me nenin 69 të LPP-së për Autorizim Marketing apo leje e importit në bazë të UA02/214 nuk janë specifike sepse janë dokumente për kualifikim që zakonisht ne praktikat e prokurimit vlerësohen me po/jo , ekziston apo nuk ekziston dëshmia e kërkuar..

Autoriteti Kontraktues ne dosje te tenderit ne mënyrë te qartë e ka specifikuar se OE për tu kualifikua lidhur me kërkesat ne aspektin teknik dhe profesionale përveç kërkesave tjera ne mënyrë te qarte në kuptim te neit 69 të LPP-së e ka specifikuar

Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02/2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e

Pra me ketë nënkupton se AK ne dosje ka len te hapur hapir mundesin furnizimit qofte me AM apo leje importi ne baze të UA/02/2014
Kërkesat e tilla kualifikuese janë në harmoni me nenin 70 i LPP-së sipas së cilit Autoriteti Kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse

organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.

Pretendimi ankimor nr. 4 - Mos zbathni i vendimit te Panelit Shqyrtues te OSHP-se nr 397, 409/22

Lidhur me ketë pretendim ne kuptim të nenit 16 të Rregullores së punës së OSHP-së Eksperti vlerëson se arsyet e anulimit dhe pretendimet ankore si rezultat i vendimit të AK-së janë pjesërisht te ndryshme ne raport me arsyet e eliminimit bazuar në vendimet paraprake.

Pretendimi ankimore nr. 5 - Kontratat e inicuara dhe te lidhura me UNOPS

Eksperti nuk mund t e jap vlerim dhe konstatim pasi qe nuk mund ti trajtoj kontratat siç theksohet në ankeës me UNOPS për faktin se organizatat e tilla si UNOPS e ne parim nuk mund te udhëheqin procedura të e prokurimit ne emër te autoriteteve kontraktues ne rast se mjetet financiare janë mjete të buxhetit te Kosovës .

Për me tepër ketë e sqarojnë dispozitat e nenit 26 të LPP-së

Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual. Përjashtimisht, për kontratat me vlera minimale që zhvillohen në Institucionet arsimore, në pajtim me nenin 19 paragrafi 4 të këtij ligji, person i autorizuar të nënshkruaj një kontratë është Drejtori i Institucionit Arsimor.
2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nga kjo rregull përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.
3. Kur Ministria e Financave cakton AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit konform nenit 95 të këtij ligji, personat e autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës janë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe ZKA-ja i AQP-së.
4. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese: 4.1.Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale; 4.2. Personat kanë konfirmuar edhe një here se informatat që gjinden në "Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" janë ende të sakta; 4.3. Personat nuk kanë pranuar asnjë komunikatë nga OSHP ose gjykata në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.

Çdo kontrate e nënshkruar ne kundërshtim me ketë dispozite të Ligjit konsiderohet jo ligjore dhe duhet të trajtohet ne instanca tjera apo edhe nga vet OSHP ne kuptim te nenit 132 të LPP-së

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet të bazuara dhe njëkohësisht propozon Autoritetit Kontraktues që të anuloj njoftimin e datës 20.10.2022 për këtë aktivitet te prokurimit

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - ""Pharma Leader"LLC
-
-